



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.43, datë 31.01.2022

PËR

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT DURREË, PËR POZICIONIN E LIRË, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 173, DATË 28.05.2020, PËR KANDIDATIN Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 31.01.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e kandidatit, z. {...} nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 173, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Dritan Hallunaj, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin nr. 173, datë 28.05.2020, për shkak të tërheqjes së kandidatit nga kandidimi,

VËREN

I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET

1. Me Vendimin nr. 173, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”

2. Me Vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”

3. Me Vendimin nr. 182, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile...”

4. Në të trija këto procedura të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Tiranë, afati i kandidimit është përcaktuar **dy javë** nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 29.05.2020, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 15.06.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë por aktualisht i komanduar si gjyqtar i skemës së delegimit pranë Gjykatës së Apelit Durrës nga data 05.11.2020 e në vijim.

II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

6. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli vendosi fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët, ndër ta edhe për z.{...}, për të cilin, pas zhvillimit të shortit, caktoi si relatore znj. Marçela Shehu.

7. Vlen të përmendet se, me synimin për plotësimin në kohë të pozicioneve të lira, ndër të tjera, edhe në gjykatat e apelit të posaçëm, kjo me qëllim për të ruajtur funksionalitetin e tyre, Këshilli, në të gjitha procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat më të larta ose të specializuara, ka konsideruar zhvillimin paralelisht të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit, me atë të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve për secilin nga pozicionet e lira. Kështu, për të filluar në kohë procesin e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, çka do të mundësonte më pas përmbylljen e procedurës së renditjes dhe ngritjes në detyrë të kandidatit të renditur më lart, Këshilli konsideroi ndarjen në dy faza të procedurës së verifikimit të kriterëve të kandidimit. Në fazën e parë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit për tre kriteret formale të kandidimit, në logjikën sipas të cilës kandidati që nuk i plotësonte këto kriterë do të duhej të skualifikohej nga kandidimi, duke mos u bërë kështu ai pjesë e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pra për të lehtësuar këtë proces dhe synuar përfundimin në kohë të tij. Ndërsa në fazën e dytë të procedurës së verifikimit, kandidatët do t’i nënshtroheshin verifikimit të kriterit të pasurisë dhe të figurës. Vetëm pas verifikimit të gjithë kriterëve të kandidimit, Këshilli do të vendoste përfundimisht për kualifikimin ose jo të çdo kandidati.

8. Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për kandidatin z. {...} në lidhje me tre kriteret formale të kandidimit të tij, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit, për pozicionet e lira të përmendura më lart, Këshilli me vendimin nr. 308, datë 10.09.2020, ka vendosur:

1. *Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 173, nr. 181 dhe nr. 182 datë 28.05.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.*
2. *Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 173, nr. 181 dhe nr. 182 datë 28.05.2020.*

9. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, në shkronjën “b”, pika 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 173, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020, përcaktohet se: “*Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen ..., si më poshtë: ... b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për*

procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

10. Për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatit, në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë ku ai ka kandiduar, në kushtet kur ai ishte subjekt rivlerësimi “*ex officio*” sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 84/2016 “Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, proces ky që për atë nuk kishte përfunduar në momentin e fillimit të procedurës së verifikimit, me Shkresën nr. 3118 prot., datë 09.07.2020, Këshilli i kërkoi Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatit, bazuar kjo në Vendimin 75/2019, ku përcaktohet se: “*Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. ...*” (Kreu X, Seksioni B, pika 2). Kjo kërkesë e Këshillit është marrë në konsideratë referuar përgjigjes, sipas Shkresës nr. 4692/1 prot., datë 17.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

11. Rezulton se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi mori në shqyrtim në seancë dëgjimore, çështjen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit {...}, me Vendimin nr. 326, datë 17.12.2020, ka vendosur:

- “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Apelit Durrës.*
- 2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.*
- 3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.*
- 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..”.*

12. Vendimi më lart i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 24.03.2021, pasi nuk u ankimua¹.

13. Në përfundim të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore për kandidatin z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të përmendura më lart në fushën e të drejtës civile, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 168, datë 22.04.2021 ka vendosur:

- 1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Tiranë (në fushën e së drejtës civile), për tre pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 173, nr. 181 dhe nr. 182, datë 28.05.2020.*
- 2. Vendimi nr. 308, datë 10.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.*

¹ Faqja zyrtare e KPK-së <https://kpk.al/z-{-...}-kalaja-gjyqtar-i-komanduar-ne-gjykatën-e-apelit-durres/>

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjat “c” dhe “ë”, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve, me vendimin nr. 57 datë 16.02.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 173, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, ka vendosur:

1. *Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 173, nr. datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. *Caktimin e z. Ilir Toska, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.*

15. Më datë 22.04.2021, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, kandidati u njoftua për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionet e lira, ku ai kandidonte, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

16. Me kualifikimin sipas pikës 13, të këtij relacioni, z. {...} ishte një nga kandidatët e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në tre pozicionet e lira ku kishte kandiduar, referuar Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”. Ndërkohë, pas përfundimit të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, sipas Vendimit të Këshillit nr. 553, datë 01.12.2021, kandidati është vlerësuar/graduar për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm” si dhe sipas Vendimit të Këshillit nr. 554, datë 01.12.2021, kandidati është vlerësuar për vitin 2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”.

III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI

17. Ndërsa për kandidatin z. {...} vijonte procedura e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 173, datë 28.05.2020, ky kandidat, me shkresën e paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, protokolluar me nr. 5629 datë 10.12.2021, ndërkohë që paraqet kërkesën për kandidim në pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 571, datë 07.12.2021, ai ka shprehur vullnetin e tij mbi tërheqjen nga kandidimi në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 173, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

18. Si pasojë e mbarimit të mandatit 3 (tre) vjeçar të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Toska, më vendimin nr. 25, datë 17.01.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

1. *Ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 57, datë 16.02.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 173, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”; ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 231, datë 02.06.2021 “Për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionet e lira, të shpallura me vendimet nr. 174, datë 28.05.2020, dhe nr. 392, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, dhe ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr. 390, datë 22.09.2021 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës,*

për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penalë, të shpallur me vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si më poshtë:

Caktimin e z. Dritan Hallunaj, si relator për këto procedura përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

19. Me datë 17.01.2022, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 30, të Vendimit të Këshillit nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” kandidati është njoftuar mbi ndryshimin e vendimit nr. 57, datë 28.05.2020 dhe caktimin e relatorit të ri, si dhe të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit. Kandidati nuk paraqiti kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

20. Në rrethanat sa sipër, bazuar në pikën 36, Seksioni B, Kreun V, të Vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 70/2020), ku përcaktohet se: “Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare”.

21. Në Mbledhjen e datës 25.01.2022 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t’u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 173, datë 28.05.2020, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure ngritjeje në detyrë për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT

22. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të gjitha niveleve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

23. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 48 të Ligjit për Statusin, procedura administrative për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: “Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin

94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

24. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 70/2020 *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”*. Kështu, në Kreun V, Seksioni B, pika 36, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim. Mbi këtë kërkesë, me propozim të relatorit të çështjes, Këshilli vendos përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Vendimi i Këshillit i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen e tij zyrtare”*.

25. Sa më sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidati z. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 173, datë 28.05.2020. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë, ndërsa ende nuk ka përfunduar procedura e përzgjedhjes, dhe Këshilli nuk kishte marrë një vendim final, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë ngritje në detyrë, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i tij për t'u tërhequr nga kandidimi.

V. KONKLUZIONE

26. Në këto rrethana, duke pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati z. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e tij për t'u tërhequr nga kandidimi për ngritjen në detyrë Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 173, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, si dhe në pikën 36, Seksioni B, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020 *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”*, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 173, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR